



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

INSPEKTORATI QENDROR

DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË INSPEKTIMEVE, UDHËHEQJES METODOLOGJIKE DHE
KOORDINIMIT

Nr. 374 prot.

Tiranë, më: 30.08.2023

URDHËR

Nr. 29, datë 30.08.2023

PËR

ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE BASHKËRENDIMIN NË FUSHË VEPRIMTARINË INSPEKTUESE TË MJEDISIT PËR INSPEKTORATIN KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT DHE AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 16 dhe nenit 49, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ‘e-Inspektimi’”, si dhe në zbatim të germës h, të pikës 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 604 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, të pikës 4, të kreut II, germa c, të pikës 6, të kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të mjedisit”, si edhe legjislacionit në fuqi për fushën e mjedisit:

URDHËROJ

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, të ushtrojë veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore në përputhje me legjislacionin për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe inspektimin në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje, vetëm për rastet kur konstatohen veprimtari të kundërligjshme të çfarëdo lloji.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të ushtrojë veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore, vetëm për rastet e inspektimit të përputhshmërisë të aktivitetit të operatorëve me kushtet/kriteret e përcaktuara në lejet mjedisore.

3. Trupa inspektuese e IKMT, kur konstaton se operatori me leje mjedisore ka thyer kushtet e lejes mjedisore, të njoftojë pa vonesë Inspektoratin Qendror edhe për kompetencë Inspektoratin e AKM, reciprokisht inspektorët e AKM, nëse marrin indicie, apo konstatojnë në flagrancë aktivitet mjedisor pa leje mjedisore, të njoftojnë Inspektoratin Qendror edhe inspektoratin e IKMT, për kompetencë.
4. Ngarkohen inspektorët shtetërorë si dhe strukturat përgjegjëse për fushën e inspektimit të mjedisit për zbatimin e këtij Urdhri.
5. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore respektive si dhe strukturave përgjegjëse, sipas fushave të inspektimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

SHKËLQIM HAJDARI

